

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË ÇËSHTJA SHEHU KUNDËR SHQIPËRISË (Kërkesa nr. 62977/09) VENDIM

STRASBURG
12 nëntor 2024

Ky vendim është përfundimtar, por mund të jetë subjekt i rishikimit redaktues.

Në çështjen Shehu kundër Shqipërisë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si një Komitet i përbërë nga:

Ioannis Ktistakis, *Kryetar,*

Darian Pavli,

Andreas Zünd, *gjyqtarë*

dhe Olga Chernishova, *zëvendëssekretare e Seksionit,*

Duke mbajtur në konsideratë:

kërkesën (nr. 62977/09) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ("Konventa"), më 26 nëntor 2009, nga një shtetas shqiptar, z. Njazi Shehu ("kërkuesi"), lindur në vitin 1948, banues në Peshkopi dhe i përfaqësuar nga znj. E. Kokona, një avokate e pranuar të ushtrojë ligjin në Tiranë; vendimin për të njoftuar mbi kërkesën Qeverinë Shqiptare ("Qeveria"), përfaqësuar nga Agjenti i saj i asaj periudhe znj. B. Lilo dhe në vijim nga z. O. Moçka, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit;

Vërejtjet e palëve;

Pasi diskutoi me dyer të mbyllura më 15 tetor 2024,

Shpall vendimin e mëposhtëm, që u miratua në të njëjtën datë:

LËNDA E ÇËSHTJES

1. Çështja ka të bëjë me mosekzekutimin e një vendimi të brendshëm për të cilin procedurat rishqyrtuese vendëse janë ende pezull.

I. VENDIMI I VITIT 1999

2. Në vitin 1992, kërkuesi bleu një sipërfaqe toke nga një organ Shtetëror.

3. Dy vjet më pas, një palë e tretë bleu tokën ngjitur ku kjo palë e tretë ndërtoi një pikë karburanti dhe një hotel.

4. Me besimin se toka i tij ishte zënë në mënyrë të paligjshme, në vitin 1999 kërkuesi bëri një padi ndaj pronarit të tokës ngjitur për largimin e tij prej tokës dhe për të marrë kompensim për përdorimin e tokës së tij.

5. Në fund të vitit 1996, i padituri e transferoi tokën e tij tek një person tjetër.

6. Më 22 dhjetor 1999, Gjykata e Rrethit Tiranë vendosi në favor të kërkuesit, duke i kërkuar të paditurit që të lironte tokën e kërkuesit dhe të paguante kompensim ("vendimi i vitit 1999"). Gjykata u mbështet tek raporti i një eksperti të caktuar nga gjykata ku konfirmohej se ndërtimi i të paditurit ishte, pjesërisht, në tokën e kërkuesit. Më 26 tetor 2006, Gjykata e Lartë e la në fuqi këtë vendim.

II. PROCEDURAT EKZEKUTUESE

7. Më 29 Dhjetor 2006, Gjykata e Rrethit Tiranë lëshoi një urdhër ekzekutimi. Në prill 2007, Zyra e Përmbartimit Tiranë emëroi një ekspert për të sqaruar situatën aktuale me sipërfaqet e tokës.

8. Më 24 maj 2007, Zyra e Përmbartimit Tiranë refuzoi të ekzekutonte vendimin e vitit 1999, me përfundimin se: (i) vendimi e kishte identifikuar në mënyrë të gabuar të pandehurin; (ii) përcaktimi i kufijve të pronës së kërkuarit në terren ishte i pamundur, dhe (iii) i pandehuri tashmë e kishte ndarë tokën në dy nënpjesë toke dhe i kishte transferuar ato tek një person tjetër.

9. Më 20 shtator 2007, me kërkesë të kërkuarit, Gjykata e Rrethit Tiranë e korrigjoi vendimin e vitit 1999 në lidhje me detajet identifikuese të të pandehurit.

10. Më 15 nëntor 2007, pas ankesës së kërkuarit për mosekzekutimin nga ana e përmbartuesit të vendimit të vitit 1999, Gjykata e Rrethit Tiranë e urdhëroi përmbartuesin të vijonte me procedurat e ekzekutimit. Ajo u shpreh se nuk i takonte përmbartuesit të vinte në pyetje gjetjet në vendimin e vitit 1999 ose të mbronte interesat e pronarëve të rinj të tokës të cilët mund të bënin paditë e tyre në gjykatë. Më 21 maj 2008, Gjykata e Apelit Tiranë la në fuqi këtë vendim.

11. Më 14 prill 2010, Gjykata Kushtetuese vendosi se përmbartuesi nuk kishte marrë masat e nevojshme për të zbatuar vendimin e vitit 1999. Ajo gjykoi se përmbartuesi kishte fuqinë e ligjshme të largonte palën e tretë nga pjesa e tokës që i përkiste kërkuarit dhe se nuk ekzistonin pengesa juridike apo faktike për të ekzekutuar vendimin e vitit 1999 (shih paragrafin 8 më sipër). Mosveprimet e përmbartuesit sipas ligjit paraqisnin një shkelje të së drejtës së kërkuarit për një gjykim të drejtë për mosekzekutimin e vendimit të vitit 1999. Nuk ka informacione për procedurat vijuese në lidhje me ekzekutimin e vendimit të vitit 1999.

III. PROCEDURAT E TJERA PËRKATËSE

12. Më 27 qershor 2012, Gjykata e Rrethit Tiranë e shpalli kërkuarin fajtor për falsifikim, midis të tjerash, të marrëveshjes së blerjes së vitit 1992, me anë të së cilës ai kishte marrë këtë tokë (shih paragrafin 2 më sipër). Apelimet e zakonshme të kërkuarit kundër vendimit u rrëzuan nga gjykatat vendëse.

13. Në vitin 2015, kërkuari paraqiti një kërkesë për rishikimin e dënimit të tij penal. Pas një sërë kalimesh në gjykata tjera, çështja është pezull pranë Gjykatës së Apelit.

14. Më 7 dhjetor 2012, një palë e tretë paraqiti një kërkesë për rishikimin e vendimit të vitit 1999 pranë Gjykatës së Lartë. Në parashtrimet e tyre të datës 25 nëntor 2021, Qeveria deklaronte se këto procedura ishin pezull përpara Gjykatës së Lartë. Parashtrimet më të fundit të Qeverisë të datës 19 Shtator 2024 nuk kishin përditësime në lidhje me këtë.

VLERËSIMI I GJYKATËS

I. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS DHE NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR. 1 PËR MOSEKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË VITIT 1999

15. Në mbështetje të nenit 6 § 1 të Konventës, dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës, kërkuari u ankua për mosekzekutimin e vendimit të vitit 1999.

A. Pranueshmëria

16. Qeveria parashtrori se kërkuari kishte paraqitur një dokument të falsifikuar pranë gjykatave vendëse, më konkretisht marrëveshjen e blerjes së vitit 1992, dhe në këtë mënyrë e kishte marrë vendimin e vitit 1999 në mënyrë të paligjshme. Sipas rrethanave, sipas këndvështrimit të Qeverisë, kërkuari kishte vepruar në keqbesim përpara Gjykatës dhe ankesa duhet të shpallet si qartazi e pabazuar. Kërkuari u përgjigj se nuk kishte falsifikuar asnjë dokument dhe se procedurat e rishikimit në lidhje me dënimin e tij ishin ende pezull.

17. Gjykata gjykon se kjo çështje lidhet ngushtë me meritat e ankesës së kërkuarit dhe për këtë arsye duhet t'i bashkohet shqyrtimit të saj. Ankesa nuk është qartazi e pabazuar sipas interpretimit të nenit 35 § 3 (a) të Konventës ose e papranueshme për ndonjë arsye tjetër. Për këtë arsye ankesa duhet të shpallet e pranueshme.

B. Meritat

18. Gjykata thekson se ekzekutimi i një vendimi dhënë nga një gjykatë duhet të konsiderohet si një pjese integrale e një “seance” sipas nenit 6 § 1. Gjithashtu, ajo i referohet praktikës së saj gjyqësore në lidhje me mosekzekutimin ose zbatimin e vonuar të vendimeve gjyqësore të brendshme (shih *Hornsby kundër Greqisë*, nr. 18357/91, § 40, *Raportet e gjykimeve dhe vendimeve* 1997-II, dhe në lidhje me Shqipërinë, *Qufaj Co. sh.p.k. kundër Shqipërisë*, nr. 54268/00, §§ 38-45, 18 nëntor 2004; dhe *Gjyli kundër Shqipërisë*, nr. 32907/07, §§ 55-61, 29 shtator 2009).

19. Shteti ka detyrimin pozitiv për të organizuar një sistem për ekzekutimin e vendimeve gjë e cila është efektive si në ligj edhe në praktikë dhe garanton ekzekutimin e tyre pa vonesa (shih *Ruianu kundër Rumanisë*, nr. 34647/97, § 66, 17 qershor 2003). Kur autoritetet detyrohen të veprojnë për të ekzekutuar një vendim dhe nuk e bëjnë këtë gjë, mosveprimi i tyre mund të angazhojë përgjegjësinë e Shtetit në mbështetje të nenit 6 § 1 të Konventës (shih *Scollo kundër Italisë*, 28 shtator 1995, §§ 44, seritë A nr. 315-C, dhe *Bushati dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, nr. 6397/04, § 79, 8 dhjetor 2009).

20. Në çështjet e tilla si çështja konkrete, e cila bën të nevojshme masat që duhet të ndërmerren nga një i pandehur, i cili është person privat, Shteti si zotërues i fuqisë publike, duhet të veprojë me kujdes për të ndihmuar paditësin e suksesshëm në ekzekutimin e një vendimi (shih *Fociac kundër Rumanisë*, nr. 2577/02, § 70, 3 shkurt 2005).

21. Për t’u rikthyer në çështjen konkrete, Gjykata i jep një rëndësi të madhe vendimit të Gjykatës Kushtetuese se përmbartuesi, një autoritet publik, nuk kishte ushtruar fuqitë e tij për të ekzekutuar vendimin e vitit 1999 duke shkelur në këtë mënyrë të drejtën e kërkuarit për një gjykim të drejtë (shih paragrafin 11 më sipër).

22. Edhe pse dënimi penal i kërkuarit për falsifikim dhe kërkesa e palës së tretë për rishikimin e vendimit të vitit 1999 mund të kenë pasoja për vlefshmërinë e vendimit, Gjykata nuk mund të spekulojë për rezultatin e këtyre procedurave, që kanë qenë pezull pranë gjykatave vendëse për një periudhë të gjatë, siç konfirmohet nga parashtrimet e palëve në shtator 2024 (shih paragrafët 13–14 më sipër). Rezultati është se deri më sot vendimi i vitit 1999 nuk është rishikuar. Për këtë arsye rezultoni se ai është në fuqi dhe i zbatueshëm (krahaso, *mutatis mutandis*, *Secleanu dhe të tjerë kundër Rumanisë*, nr. 2915/02, § 40, 12 janar 2010).

23. Për këtë arsye, ankesa paraqet një shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 për shkak të mosveprimit me kujdes nga ana e përmbartuesit dhe në kohë për të ndihmuar kërkuarin në ekzekutimin e vendimit të vitit 1999.

II. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 13 TË KONVENTËS

24. Kërkuari u ankua edhe në mbështetje të nenit 13 të Konventës për mungesën e një mjeti efikas për mosekzekutimin e vendimit të vitit 1999. Në lidhje me faktet e çështjes, parashtrimet e palëve dhe gjetjeve të saj më sipër, Gjykata vlerëson se ajo ka shqyrtuar çështjen kryesore juridike në çështjen konkrete. Ajo gjykon se nuk ekziston nevoja për të dhënë një gjykim të veçantë për këto ankesa (shih *Qendra për Burimet Juridike në emër të Valentin Câmpeanu kundër Rumanisë* [DHM], nr. 47848/08, § 156, GJEDNJ 2014).

ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

25. Kërkuari nuk paraqiti një kërkesë për gjykim të drejtë ose kostot dhe shpenzimet. Në përputhje me rrethanat, nuk ka asnjë të dhënë për t’i akorduar atij ndonjë shumë për këtë aspekt.

26. Në vijim, Gjykata thekson se Shteti i paditur ka detyrimin e mbetur pezull për të ekzekutuar vendimin e vitit 1999, për aq kohë sa ai është në fuqi.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME,

1. *E shpall* të pranueshme ankesën e kërkuarit në lidhje me mosekzekutimin e vendimit të vitit 1999 dhe *vendos* se nuk është e nevojshme që ankesa e kërkuarit të bëhet në mbështetje të nenit 13 të Konventës të shqyrtohet veçantë;

2. *Gjykon* se mosekzekutimi i vendimit të vitit 1999 paraqet një shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 12 nëntor 2024, në mbështetje të Rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Olga Chernishova
Zëvendëssekretare

Ioannis Ktistakis
Kryetar